



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.54/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1375-2026, të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 01.07.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.54/2026, e datës 29.06.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1375-2026, të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 29.06.2026 Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar ankesën nr.ZP.Anr.54/2026, të parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në mbledhjen nr. 69/2026 të mbajtur më 27.06.2026, ka shpallur rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026, ndonëse, sipas ankuesit, këto rezultate janë të pasakta dhe të paverifikuara, duke cenuar të drejtën e tij për një proces zgjedhor të drejtë, transparent dhe të barabartë. Ankuesi, pretendon se, rinumërimi i zhvilluar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), i cili ka përfunduar më 19.06.2026, nuk e ka konfirmuar saktësinë e numërimit fillestar të kryer në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Sipas ankuesit, nga ky rinumërim ka rezultuar se në një numër i konsiderueshëm rastesh, votat e zgjedhësve ishin atribuar gabimisht kandidatëve të ndryshëm. Ankuesi thekson se, vetëm nga rinumërimi i 185 vendvotimeve iu kanë shtuar gjashtë (6) vota të vlefshme, të cilat nuk ishin regjistruar gjatë numërimit fillestar. Sipas rezultateve përfundimtare të publikuara nga KQZ më 27.06.2026, kandidati Rustem Mustafa ka fituar 20.643 vota, ndërsa ankuesi 20.541 vota,

me një diferencë prej vetëm 102 votash. Sipas ankuesit, kjo diferencë është aq e ngushtë sa që çdo gabim i mundshëm në rinumërim mund të jetë vendimtar për ndarjen e mandatit të deputetit. Tutje, ankuesi i referohet deklaratës publike të Kryesuesit të KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, gjatë shpalljes së rezultateve përfundimtare, i cili ka pranuar se gjatë rinumërimit ishin evidentuar gabime, të cilat i ka cilësuar si "minimale" dhe "njerëzore". Sipas ankuesit, kjo deklaratë përbën pranim zyrtar se gjatë numërimit fillestar kanë ekzistuar gabime, ndërsa raporti i detajuar i rinumërimit nuk ishte bërë publik deri në atë kohë. Për pasojë, ai pretendon se nuk ka pasur qasje në të dhënat e nevojshme për të identifikuar vendvotimet ku ishin konstatuar parregullsitë, duke u cenuar kështu parimi i barazisë.

Me tutje ankuesi thekson se, nga rinumërimi i vetëm 5.201 votave të PDK-së janë evidentuar gjithsej 221 ndryshime në votat preferenciale ndërmjet kandidatëve të këtij subjekti politik, çka, sipas tij, paraqet një marzhe gabimi prej 4.25%, i cili nuk mund të konsiderohet minimal, pavarësisht këtij niveli të gabimeve dhe diferencës prej vetëm 102 votash ndërmjet kandidatëve, KQZ ka shpallur rezultatet përfundimtare pa ndërmarrë ndonjë verifikim shtesë për mbi 96.48% të votave preferenciale të kandidatëve të PDK-së, megjithëse gabimet e evidentuara mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar.

Andaj, ankuesi konsideron se, për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor, sigurinë juridike, respektimin e të drejtës për zgjedhje të lira dhe demokratike, si dhe vullnetin e zgjedhësve, është i domosdoshëm rinumërimi i plotë i votave preferenciale të kandidatëve të PDK-së. Për këtë arsye, ka kërkuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, të konstatohet se rinumërimi i 185 vendvotimeve, i urdhëruar me Vendimin e KQZ-së, ka provuar ekzistencën e gabimeve në numërimin fillestar në QKN, të konstatohet se kryesuesi i KQZ-së në mbledhjen nr.69/2026 të datës 27.06.2026, ka pranuar publikisht ekzistencën e gabimeve, ndërsa mospublikimi i raportit të rinumërimit gjatë procesit ankimor ka cenuar barazinë dhe të drejtën e ankuesit për mjet juridik efektiv si dhe të urdhërohet KQZ, të urdhërohet KQZ që para certifikimit, të zhvillojë rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike të Kosovës nga të gjitha fletëvotimet e numëruara në QKN të cilat nuk u përfshinë në Vendimin nr. 01/1300/2026, me ndikim përcaktues për kandidates Bekim Haxhiu (nr.109) dhe Rustem Mustafa (nr.15), të obligohet KQZ që pas rinumërimit, ti përpilojë dhe publikojë rezultatet e reja përfundimtare në përputhje me ligjin dhe të garantojë transparencë të plotë gjatë procesit, duke mundësuar praninë e vëzhguesve të akredituar përfaqësuesve të subjekteve politike e mediave.

Si prova në ankesë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur rezultatin përfundimtar i KQZ-së nga mbledhja nr.69/2026, datë 27.06.2026, transkriptin nga kjo mbledhje duke përfshirë deklaratën e Kryesuesit të KQZ-së, vendimin e KQZ-së nr.01/300-2026, datë 17.06.2026 për rinumërimin e 185 vendvotimeve, tabelën e votave të kandidatëve të PDK-së para dhe pas rinumërimit në QNR, tabelën e përqindjes së votave të rinumëruara sipas komunave dhe subjekteve politike, analizë statistikore dhe projeksion i ndikimit të gabimeve, vendimin e PZAP-së ZP.Anr.52/2026, datë 22.06.2026 si dhe vendimin e Gjykatës Supreme A.Anr.27/2026.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në përgjigje në ankesë, ka theksuar se, me vendimin e KQZ-së nr.01/300-2026 të datës 17.06.2026, është urdhëruar rinumërimi i plotë i 18 vendvotimeve të rregullta, që përbëjnë 7.41% të gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta. Procesi i rinumërimit në QNR ka filluar me 18.06.2026, në orën 08:00 dhe është përmbyllur më 19.06.2026 në orën 12:00. Sa i përket kandidatit Bekim Haxhiu, ndryshimet janë

evidentuar në shtatë vendvotime, ku në 6 raste votat e tij janë rritur ndërsa në një vendvotim ka një votë me pak. Tutje në përgjigje ka theksuar se, raporti nga rinumërimi tregon se ndryshimet në votat e kandidatëve kanë qenë në të dy drejtimet, me vota të shtuara dhe të zbritura. Shumica e dallimeve, përkatësisht rreth 92% kanë qenë vetëm nga një votë për kandidat në një vendvotim, ndërsa dallimet më të mëdha janë paraqitur rrallë dhe nuk kanë tejkaluar katër vota për kandidat në një vendvotim. Në këto rrethana, ndryshimet e evidentuara paraqiten si të kufizuara dhe të izoluara, të lidhura kryesisht me rivlerësimin e fletëvotimeve dhe me gabime njerëzore gjatë numërimit fillestar, pa krijuar bazë të mjaftueshme për të nxjerrë përfundim për një model të përgjithshëm ose sistematik të pasaktësive në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërim. Tutje, KQZ ka shtuar se, në kuptim të nenit 106 ankesa pas shpalljes së rezultateve përfundimtare mund të lidhet me pretendime që burojnë nga akti i shpalljes së rezultateve, përkatësisht nga përlllogaritja, tabulimi, pasqyrimi i rezultateve, ndarja e mandateve ose përcaktimi i kandidatëve të zgjedhur. Në rastin konkret, ankuesi nuk pretendon ndonjë gabim konkret për këto rrethana. Për rrjedhojë, ankesa është paraqitur formalisht kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare, përmbajtja e saj materiale lidhet me procesin e numërimit dhe rinumërimit të votave, për të cilin zbatohet afati i përcaktuar me nenin 105 të LZP-së. Kërkesa e ankuesit për rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të PDK-së tashmë është shqyrtuar në rastin ZP.Anr.52/2026, i vërtetuar me vendimin e Gjykatës Supreme A.Anr.27/2026.

KQZ, ka kërkuar nga PZAP që ta hedhë ankesën në pjesën që kërkon rinumërimin e plot të votave preferenciale të kandidatëve të PDK-së, pasi që për të njëjtën çështje është vendosur me parë më vendimin ZP.Anr.52/2026 dhe është konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A.A.nr.27/2026, të konstatoj se pretendimet e ankuesit që lidhen me administrimin e numërimit në QKN dhe rinumërimin në QNR, nuk mund të rihapen përmes ankesës kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare sipas nenit 106, par.3 të LZP-së, pasi ato i nënshtrohen afatit prej 48 orësh të përcaktuar me nenin 105 të këtij ligji si dhe në alternativë, nese ankesa shqyrtohet në themel, ta refuzoj atë si te pabazuar. KQZ, në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur Raportin nga rinumërimi i 185 vendvotimeve të rregullta për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura me 7 Qershor 2026.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli fillimisht konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e lejuar në kuptim të nenit 106.3 të LZP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit të parapare ligjor, pasi që rezultati përfundimtar nga KQZ është shpallur me datë 27.06.2026 në ora 12:00 kështu që ankesa është paraqitur me datë 29.06.2026.

Paneli i vlerësoi pretendimet e ankuesit në bazë të nenit 106.3 të LZP-së, të paraqitura pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ, me të cilën kërkohet rinumërimi i plotë i votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK, duke u mbështetur në ndryshimet e evidentuara gjatë procesit të rinumërimit të zhvilluar para shpalljes së rezultateve.

Paneli vlerëson se procedura e ankesave pas shpalljes së rezultatit përfundimtar ka për qëllim shqyrtimin e pretendimeve të mbështetura në prova konkrete që mund të vënë në dyshim ligjshmërinë ose saktësinë e rezultatit të shpallur, e jo rivlerësimin e çështjeve që tashmë kanë

qenë objekt shqyrtimi gjatë fazave paraprake të administrimit dhe verifikimit të procesit zgjedhor.

Në këtë drejtim, Paneli vlerëson se ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij është bazuar në të njëjtat të dhëna dhe rezultate të rinumërimit që kanë qenë të njohura dhe të disponueshme edhe më herët gjatë procesit zgjedhor dhe që kanë qenë objekt vlerësimi nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me vendimin ZP.Anr.52/2026, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A.A.nr.27/2026, ndërsa në këtë fazë të procesit ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re, konkrete dhe të individualizuar, e cila do të dëshmonte ekzistimin e parregullsive apo të një natyre të tillë që do të justifikonte ndërhyrjen në rezultatin përfundimtar të shpallur.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me diferencën prej vetëm 102 votash ndërmjet tij dhe kandidatit të renditur para tij, Paneli konsideron se ndonëse kjo rrethanë mund të jetë relevante për interesin individual të ankuesit, ajo nuk mund të zëvendësojë kërkesën ligjore për paraqitjen e provave konkrete që do të justifikonin urdhërimin e rinumërimit të përgjithshëm.

Sipas vlerësimit të Panelit, KQZ-ja me vendimin nr.01/300-2026 të datës 17.06.2026, ka urdhëruar rinumërimin e plotë të 185 vendvotimeve të rregullta, që përbëjnë 7.41% të gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta. Procesi i rinumërimit në QNR ka filluar me 18.06.2026, në orën 08:00 dhe është përmbyllur më 19.06.2026 në orën 12:00. KQZ ka përpiluar raport nga procesi i rinumërimit, nga i cili raport rezulton se krahasimi i votave të kandidatëve pas rinumërimit, rezulton se shumica e dallimeve janë minimale, pra vetëm nga një votë për kandidat në një vendvotim janë 92 % e dallimeve. Janë evidentuar 1,342 raste me rritje një votë dhe 1,023 raste me zbritje një votë. Dallimet më të mëdha janë më të rralla: 118 raste me rritje dy vota, 16 raste me tri vota dhe vetëm 2 raste me katër vota me shumë. Ndërsa, janë evidentuar 77 raste me zbritje dy vota, 4 raste me tri vota dhe 2 raste me katër vota. Bazuar në natyrën dhe përmasën e këtyre dallimeve, mund të vlerësohet se ato lidhen kryesisht me ri kategorizimin e fletëvotimeve gjatë rinumërimit, si dhe me gabime njerëzore gjatë numërimit në QKN. Në këto rrethana, ndryshimet e evidentuara paraqiten si të kufizuara dhe të izoluara, të lidhura kryesisht me rivlerësimin e fletëvotimeve dhe me gabime njerëzore gjatë numërimit fillestar, që do të thotë se nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për të nxjerrë përfundim për një model të përgjithshëm ose sistematik të pasaktësive në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërim.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se, gjatë mbledhjes së KQZ-së janë pranuar publikisht gabime të evidentuara gjatë rinumërimit, Paneli vlerëson se konstatimi i ekzistimit të gabimeve të karakterit njerëzor apo teknik gjatë procesit zgjedhor i është referuar raportit të publikuar për procesin e rinumërimit, ndërsa ky konstatim nuk paraqet bazë të mjaftueshme juridike për të urdhëruar rinumërim të përgjithshëm, pa u dëshmuar se natyra, shtrirja dhe efekti i këtyre gabimeve kanë cenuar në mënyrë konkrete saktësinë e rezultatit përfundimtar.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara Paneli ka vlerësuar se ankesa e paraqitur nga kandidati për deputet të Kuvendit Kosovës Bekim Haxhiu, është e pabazuar, pasi që pretendimet e paraqitura në ankesë mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në prova materiale që do të mundësonin konstatimin e një shkeljeje zgjedhore. Vetë pretendimi për manipulim apo tjetërsim të vullnetit të votuesve nuk mund të merret si bazë për aprovimin e ankesës pa prova

konkrete dhe të verifikueshme. Për rrjedhojë, në mungesë të provave konkrete, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe lidhur me çështjen që është objekt shqyrtimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.54/2026 datë 01.07.2026

Kryesuese e Panelit

Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



A.A.nr.32/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Albert Zogaj, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve për deputet të PDK-së, në të gjitha fletëvotimet, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 7 qershor 2026, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.54/2026, të datës 01.07.2026, në seancën e mbajtur më datë 06.07.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e parashtruar nga ankuesi: Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.54/2026, të datës 01.07.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.52/2026, të datës 22.06.2026, është vendosur: REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.54/2026, e datës 29.06.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1375-2026, të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026.

Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme, ka parashtruar Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale zgjedhore, cenim i të drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur (neni 45), cenim i barazisë procedurale dhe të drejtës për mjet efektiv (nenet 24, 31 dhe 32 të Kushtetutës), mospërfilljes së fakteve dhe provave të reja, të cilat, të vlerësuara në tërësinë e tyre, e ndryshojnë themelësisht peshën e provave në krahasim me atë që kishte në dispozicion PZAP.



Ankuesi, thekson se tani ka një raport zyrtar të lëshuar nga KQZ-ja, i cili përbën provë të drejtpërdrejtë, parësore dhe të pa kontestueshme. KQZ-ja nuk ka bërë publik dhe as nuk ka ofruar PZAP listën e plotë të ndryshimeve të votave të kandidatëve për deputet. KQZ si organ që administron me procesin zgjedhor është shndërruar në palë në procedurë në shkeljen e të drejtës kushtetuese të kandidatit Bekim Haxhiu, duke mos qenë transparente dhe duke bërë përpjekje që gabimet e numërimit fillesat në QKN si rezultat preliminar ti mbulojë dhe minimizojë. Certifikimi i rezultatit përfundimtar nuk mund të ndodhë me gabime tani të evidentuara në kundërshtim me nenin 101 të Ligjit për Zgjedhje.

Ankuesi, kërkon rinumërimin e votave preferenciale të kandidatëve të PDK-së nga fletëvotimet e numëruara në QKN që nuk u përfshinë në mostrën fillestare prej 185 vendvotimesh.

Ndërsa, ankuesi Bekim Haxhiu i ka propozuar Gjykatës Supreme, që të: Aprovoj si të bazuar ankesën; Anulohet vendimi i panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtesa ZP.Anr.54/26, datë 01.07.2026; Konstatohet se raporti zyrtar i sekretariatit të KQZ-së, për rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta (datë 22.06.2026) vërteton ekzistencën e gabimeve të përhapura; Konstatohet se në sistemin e listës së hapur të përcaktuar me nenet 110 dhe 111 të LZP-së, shkalla relevante e gabimit për kontestin konkret ndërmjet kandidatëve Bekim Haxhiu dhe Rustem Mustafa është shkalla e rialokimit të votave mes kandidatëve të PDK-së (10.71%), e jo bilanci neto i subjektit politik në tërësi; Konstatohet diferenca prej 102 votash ndërmjet ankuesit dhe kandidatit Rustem Mustafa, e krahasuar me shkallën e dokumentuar dhe të projektuar të gabimit, e bën të domosdoshëm verifikimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve për deputet të PDK-së, nga të gjitha fletëvotimet e numëruara në QKN, që nuk u përfshinë në Vendimin e KQZ-së nr. 01/1300-2026, me theks të veçantë në raportin konkret të votave ndërmjet kandidatëve Bekim Haxhiu (nr. 109) dhe Rustem Mustafa (nr. 15); Obligohet KQZ-ja, që pas përfundimit të rinumërimit: a) të përpilojë dhe publikojë menjëherë rezultatet e reja përfundimtare, b) të garantojë transparencë të plotë gjatë gjithë procesit, duke mundësuar praninë e vëzhguesve të akredituar, përfaqësuesve të subjekteve politike dhe përfaqësuesve të subjekteve politike dhe përfaqësuesve të mediave dhe c) të sigurojë që certifikimi përfundimtar të mos ndodhë përpara përfundimit të këtij verifikimi.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar ka theksuar se e kundërshtojmë në tërësi ankesën e paraqitur kundër vendimit ZP.Anr.54/2026 të datës 01.07.2026, PZAP ka refuzuar ankesën e kandidatit për deputet Bekim Haxhiu për arsye se Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës kishte gjetur se procedura e ankesave pas shpalljes së rezultatit përfundimtar ka për qëllim shqyrtimin e pretendimeve të mbështetura në prova konkrete që mund të vënë në dyshim ligjshmërinë ose saktësinë e rezultatit të shpallur, e jo rivlerësimin e çështjeve që tashmë kanë qenë objekt shqyrtimi gjatë fazave paraprake të administrimit dhe verifikimit të procesit zgjedhor.

Paneli ka vlerësuar se ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij është bazuar në të njëjtat të dhëna dhe rezultate të rinumërimit që kanë qenë të njohura dhe të disponueshme edhe më herët gjatë procesit zgjedhor dhe që kanë objekt vlerësimi nga PZAP me vendimin ZP.Anr.52/2026, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A.A.nr.27/2026, ndërsa në këtë fazë të procesit ankuesi nuk kishte paraqitur ndonjë provë të re, konkrete dhe të individualizuar, e cila



do të dëshmonte ekzistimin e pa rregullsive apo të një natyre të tillë që do të justifikonte ndërhyrjen në rezultatin përfundimtar të shpallur.

Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

- Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.54/2026, nga Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i cili ka kërkuar rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve për deputet të subjektit politik PDK në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, me vendimin ZP.Anr.54/2026, të datës 01.07.2026, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga kandidati Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

- Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e parashtruar nga Bekim Haxhiu kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë lidhur me rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve për deputet të subjektit politik PDK në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, lidhur me Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtur me datë 7 Qershor 2026.

Gjykata Supreme pretendimin e ankuesit për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e trajton si pretendim të pa bazë, sepse gjendja faktike në vendimin e atakuar është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, pasi ankuesi me ankesën e tij nuk ka bashkëngjitur asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e tij sikurse me ankesë përveç raportit të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve të cilët pas rinumërimit të 185 vendvotimeve apo 7.41 % të gjithsejt vendvotimeve ka rezultuar me një gjendje të ndryshimit ku 148 vota janë më shumë për 53 kandidatë dhe 79 vota më pak për 37 kandidatë. Ankuesi tërë ankesën e tij dhe kërkesën brenda ankesës për rinumërim të tërësishëm të votave të kandidatëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës e mbështet në rezultatet e rinumërimit të bërë nga vet Komisioni Qendrorë Zgjedhor, gjë që as nuk përbën bazë të mjaftueshme për rinumërim të plotë e as provë bindëse për Gjykatën Supreme.



Sipas gjykatës, vendimi i PZAP është i drejtë, i ligjshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se drejtë është zbatuar Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara në ankesë, nga kolegji i Gjykatës Supreme vlerësohen të pabazuara.

Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës, përkatësisht sipas raportit nga rinumërimi i 185 vendvotimeve të rregullta për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura me 07 qershor 2026, rezulton se, pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në rezultatet e kandidatëve në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh minimalisht kanë fituar vota, ndërsa kandidatë të tjerë po ashtu në mënyrë minimale kanë humbur disa vota.

Nga raporti evidentohet se krahasimi i votave të kandidatëve pas rinumërimit, shumica e dallimeve janë minimale, pra vetëm nga një votë për kandidat në një vendvotim janë 92 % e dallimeve. Janë evidentuar 1,342 raste me rritje një votë dhe 1,023 raste me zbritje një votë. Dallimet më të mëdha janë më të rralla: 118 raste me rritje dy vota, 16 raste me tri vota dhe vetëm 2 raste me katër vota me shumë. Ndërsa, janë evidentuar 77 raste me zbritje dy vota, 4 raste me tri vota dhe 2 raste me katër vota.

Nga raporti rezulton se bazuar në natyrën dhe përmasën e këtyre dallimeve, mund të vlerësohet se ato lidhen kryesisht me ri kategorizimin e fletëvotimeve gjatë rinumërimit, si dhe me gabime njerëzore gjatë numërimi në QKN.

Këto të dhëna janë publikuar në mënyrë progresive për secilin vendvotim, kategori dhe komunë, si dhe në formë të përmbledhur, duke qenë të qasshme dhe lehtësisht të verifikueshme për ankuesin dhe publikun, prandaj Gjykata Supreme, vlerëson se pretendimi se pas numërimit do të ketë rezultate pozitive, nuk është i bazuar në prova konkrete apo të dhëna zyrtare. Sipas raportit nga rinumërimi, konstatohen se ndryshimet në votat e kandidatëve kanë qenë në të dy drejtimet, me vota të shtuara dhe të zbritura, ndërsa shumica e dallimeve, përkatësisht rreth 92% kanë qenë vetëm nga një votë për kandidat në një vendvotim.

Sipas Gjykatës Supreme, gabimet e konstatuara nga KQZ-ja në procedurë të brendshme të rinumërimit nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për rinumërim të tërësishëm sikurse pretendon ankuesi, kjo sepse marzha e gabimit në raport me ankuesin është minimale 0.1154 % apo rreth 0.12 %, madje nuk ekziston asnjë indikator se gabimet janë bërë qëllimshëm për favorizim të kandidatëve të caktuar për qëllim të dëmtimit të kandidatëve të caktuar.

Pretendimi se ankuesi është vetëm 102 vota prapa kandidatit të fundit nga i njëjti subjekt në listë, përsëri, për gjykatën nuk shërben si bazë se nga rinumërimi i tërësishëm mund të ketë ndryshim në renditje, prandaj këto pretendime të kësaj natyre, mbeten vetëm supozime pa mbështetje sepse rinumërimi i KQZ-së nuk arrin të provojë bindshëm atë që pretendon ankuesi. Vendimet gjyqësore mbështeten në prova bindëse dhe të qarta dhe jo në supozime individuale dhe përlllogaritje personale.



Gjykata vlerëson se korrigjimet e evidentuara apo të pasqyruara në raport, nuk krijojnë një bazë objektive për të konkluduar se procesi i numërimit është karakterizuar nga parregullsia sistematike. Natyra dhe shpërndarja e këtyre korrigjimeve tregojnë se ato kanë qenë sporadike dhe nuk kanë arritur një intensitet të tillë që do të cenonte besueshmërinë e rezultatit përfundimtar apo integritetin e procesit të numërimit. Në këtë kuptim të dhënët e prezantuara nuk shërbejnë si bazë për aprovimin e ankesës dhe as për rinumërimin e plotë të të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të Partisë Demokratike të Kosovës, për kandidatët për deputet, e për të gjitha vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e urdhëruar me Vendimin nr. 01/1300-2026.

Po ashtu, Gjykata Supreme gjen se ankuesi nuk ka paraqitur prova konkrete që do të mbështesnin pretendimet e tij për ekzistimin e parregullsive në procesin e numërimit përtej mostrës së verifikuar. Në veçanti, ai nuk ka paraqitur formularë të rezultateve, raporte të vëzhguesve, kundërshtime të evidentuara gjatë procesit të numërimit, apo ndonjë provë tjetër relevante nga e cila do të rezultonte se pasaktësitë e konstatuara në mostër/raport janë shfaqur edhe në vendvotime të tjera, ose se ato kanë qenë të natyrës sistematike. Për rrjedhojë, pretendimi se gabime të ngjashme mund të kenë ekzistuar edhe në vendvotimet e tjera mbetet në nivel hipotetik/supozime dhe nuk mbështetet në mënyrë të provuar siç kërkohet nga rregullat e procedurës zgjedhore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, procesi i rinumërimit të 185 vendvotimeve është urdhëruar nga KQZ-ja në kuadër të mekanizmit kontrollues të paraparë me ligj, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit, dhe jo si pasojë e konstatimit të parregullsive sistematike në administrimin apo numërimin e votave.

Gjykata Supreme vlerëson se, ndonëse ankesa aktuale është paraqitur në një fazë tjetër të procesit zgjedhor, pas publikimit të raportit të KQZ-së dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare, pjesa më e madhe e pretendimeve të ngritura prej ankuesit janë të natyrës së njëjtë me ato që janë shqyrtuar më parë nga PZAP dhe Gjykata Supreme sipas aktgjykimit AA.nr.27/26 i datës 26.06.2026. Këto pretendime kanë të bëjnë me të njëjtat çështje juridike dhe faktike lidhur me kërkesën për rinumërim të fletëvotimeve të subjektit PDK. Për rrjedhojë, duke qenë se këto çështje janë trajtuar dhe arsyetuar në mënyrë të plotë në vendimet e mëparshme, Gjykata Supreme në këtë çështje lejueshmërinë e ankesës e ka vlerësuar në kuptimin se objekt shqyrtimi është vendimi i PZAP-së, i nxjerr pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, pavarësisht se në masë të konsiderueshme çështja në fjalë është konsumuar nga vendimet mëparshme të PZAP-së dhe Gjykatës Supreme.

Gjykata Supreme e vlerëson të pa themeltë pretendimin e paraqitur në ankesë lidhur me mangësitë e arsyetimit të vendimit të PZAP-së, për shkak se vendimi i PZAP-së, e ka trajtuar në substancë çështjen ankimore duke e pranuar si të provuar raportin e KQZ-së për rinumërimin e 185 vendvotimeve, mirëpo të gjeturat e raportit, respektivisht shkallës të gabimeve për kandidatët e subjektit në fjalë i ka vlerësuar se në kuptim të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nuk ndikojnë në masën që të urdhërohet rinumërimi i tërësishëm. Në këtë kuptim vlerësohet se gjendja e konstatuar faktike e nxjerrë nga vlerësimi i mekanizmit kontrollues nuk ka krijuar bazë të provuar mbi marzhën e gabimeve se nga procesi i rinumërimit mund të nxirret



rezultat tjetër. Në këtë proces vlerësohet po ashtu mundësia që kanë secili kandidat, subjekt për të evidentuar gabimet e kontestuar në të gjitha fazat e procesit të votimit dhe numërimit. Prandaj Gjykata Supreme ka gjetur se vendimi i PZAP nuk është i përfshirë në shkelje sa i përket strukturës dhe përmbajtjes së vendimit.

Gjykata Supreme thekson se, KQZ-si organ që administron me procesin zgjedhor, edhe në të kaluarën ka marrë vendim për rinumërim sepse është mekanizëm i brendshëm që diktohet nga monitorimi i procesit qoftë të votimit por edhe numërimit dhe ka pasur raste që edhe në të kaluarën të ndryshoj rezultati zgjedhor për këtë është mekanizëm vet kontrollues dhe korrektues por kjo asnjëherë nuk ka përbërë bazë të mjaftueshme për të shkuar në rinumërim, nëse kandidati nuk ka provuar se mbi cilën bazë faktike e mbështet pretendimin e cenimit të së drejtës së tij, në cilat vendvotime si arrin të provojë dyshimin për manipulim në ato vendvotime etj.

Rinumërimi në rastin konkret nuk është masë proporcionale sikurse pretendon ankuesi pasi në njërin anë kemi një proces zgjedhor që është proces me afate të shkurtra dhe të qarta, kemi standarde ndërkombëtare që inkurajojnë që sa më shpejt të përfundohet procesi me certifikim të rezultateve, në anën tjetër kemi numër minimal të ankesave që i referohen "gabimeve apo manipulimit në numërim të votave", kjo nuk përbën masë proporcionale, e kundërta e proporcionalitetit është rinumërimi sikurse në rastin konkret mbështetur vetëm në rezultatin e KQZ-së pas rinumërimit të pjesshëm.

Në asnjë rrethanë rezultati aktual i rinumërimit të KQZ-së nuk përbën bazë të mjaftueshme për rinumërim të tërësishëm, e as praktika juridike zgjedhore në Kosovës si e PZAP-it por edhe Gjykatës Supreme nuk njeh raste kur vendimi për rinumërim është mbështetur ekskluzivisht vetëm në një fakt të tillë sikurse në rastin konkret.

Për rrjedhojë Gjykata Supreme vlerëson se PZAP ka vendosur drejtë lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit, kandidatit për deputet të Kuvendit Kosovës Bekim Haxhiu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe atë duke iu referuar dispozitës nga neni 118.1 të LZP-së, ku është përcaktuar se: *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe nenit 13 paragraf 4 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, ku është përcaktuar se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*. Po ashtu me nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Mbi këtë bazë kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e lartcekura se PZAP e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke neglizhuar parimin e integritetit të procesit zgjedhor, me shkelje të ligjit material dhe të drejtave themelore të njeriut.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara.



Andaj, bazuar në arsyetimin e dhënë si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

A.A.nr.32/2026, më datë 06.07.2026.

Kryetar i kolegjit,
Qerim Ademaj



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Punëtori i autorizuar
Ovlaśceni radnik